



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 23.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kryetarin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, zotin Ilir Zela, lidhur me shqyrtimin e raportit vjetor të AKEP-it për vitin 2017. (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatjana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Agron Çela dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Ilir Zela – kryetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Altin Rrapaj – shef kabineti pranë AKEP-it

Ketrin Topçiu – anëtare e Këshillit Drejtues të AKEP-it

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Vijojmë me axhendën që kemi parashikuar për këtë javë, raportimin e AKEP-it për vitin 2017. Relator është zoti Rakip Suli. Të ftuar janë Ilir Zela, Altin Rrapaj dhe Ketrin Topçiu. Mirë se erdhët në komision!

Fjalën e ka kryetari i AKEP-it, zoti Zela. Nëse ka pyetje dhe komente nga kolegët, vazhdojmë më pas.

Ne e kemi raportin para dhe duam një pasqyrë të ngjarjeve kryesore të vitit 2017. Ju keni marrë disa vendime të rëndësishme gjatë kësaj periudhe, një prej të cilave vlen për t'u përshëndetur dhe për t'u përgëzuar, ku ofertat 28 ditore janë bërë 30 ditore.

Fjala për ju.

Ilir Zela - Faleminderit, zoti kryetar!

Dua t'ju falënderoj ju personalisht, si dhe anëtarët e këtij komisioni për vëmendjen e posaçme që keni treguar për aktivitetin e AKEP-it. Kjo është hera e katërt që jam në këtë komision, duke përfshirë edhe herën e parë kur kam ardhur të paraqes prioritetet e AKEP-it nga momenti kur u bë ndryshimi i drejtimit në AKEP.

Dua të theksoj se të gjitha pikat e rezolutës së vjetshme të Kuvendit, ku përcaktoheshin drejtimet kryesore të veprimtarisë së AKEP-it, janë adresuar gjatë vitit 2017 dhe në muajt e parë të vitit 2018.

Kemi një fokus të shtuar të AKEP-it me nënçështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përfitimet e pajtimtarëve. Po ashtu kemi ndërmarrë veprime konkrete edhe në tri drejtimet kryesore të punës së AKEP-it, të cilat janë: kushte të favorshme për investitorët, nxitje e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve të rrjeteve (mungesë dëgjimi) shërbimeve dhe rritje e efikasitetit të brendshëm (mungesë dëgjimi) me institucionin.

Çështja kryesore që dua të sjell në vëmendje është fakti që në vitin 2017 vihet re një rënie e ndjeshme e të ardhurave në tregjet e komunikimeve elektronike dhe postare, rënie që shkon deri në 15% të të ardhurave vjetore, e cila përbën shqetësim për ne. Ne jemi duke parë arsyet kryesore që qëndrojnë pas kësaj rënie, me idenë që një rënie e tillë sjell shqetësim në aftësinë e operatorëve për të investuar dhe njëkohësisht në cilësinë e shqyrtimeve të komunikimeve elektronike dhe postare. Nëse kjo rënie do të vazhdojë, sjell një shqetësim shumë të madh për gjendjen se si do të

jetë ecuria e këtyre shërbimeve. Zgjidhjen e këtij shqetësimi ne e gjejmë te kushtet e favorshme për investitorët, në mënyrë që të kemi nxitje për investime. Një nga masat që ne po marrim, në mënyrë që të ketë ambient sa më miqësor për investitorët, është vënia në dispozicion e operatorëve për spektrin për shërbimet 4G dhe 800 mgh. Ne jemi në një proces bashkëpunimi me ministrinë, në mënyrë që vlera minimale e ofertave të jetë diçka që nuk do të sjellë rëndesa të paarsyeshme për operatorët, përkundrazi, t'i nxisë ata që të investojnë. Ndërkohë, jemi duke shtuar qartësimin e rregullave për ndarjen e infrastrukturës, në mënyrë që të mos nxisin investimet në shërbime.

Lidhur me nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve, mund të themi që në fund të vitit 2017, por edhe gjatë këtyre muajve kemi përmbyllur të gjitha proceset e hapura të analizave të tregut dhe jemi në fazën e përcaktimit të detyrimeve rregullatore proporcionale.

Lidhur me përfitimet e konsumatorëve, mund të themi që kemi një përqendrim shumë të rëndësishëm të vëmendjes sonë në këtë çështje, ku përmendëm kthimin e faturimit 30-ditor nga gjendja e mëparshme, e cila ishte me 28 ditë, por nuk është vetëm kjo, pasi kemi marrë masa të tjera shumë të rëndësishme, siç është (nuk kuptohet) brenda 24 orëve dhe njëkohësisht kemi qartësuar procedurat e njoftimeve dhe publikimeve të operatorëve ndaj pajtimtarëve. Për çdo ndryshim në tarifa apo në ndonjë vend tjetër të shërbimit, operatorët janë të detyruar të njoftojnë pajtimtarët në mënyrë të përshtatshme, të paktën 30 ditë para, të njoftojnë AKEP-in 15 ditë para dhe njëkohësisht të publikojnë këto ndryshime në media në formën e duhur, të paktën 7 ditë para. Kjo do të rrisë në mënyrë të dukshme nivelet e qasjes ndaj pajtimtarëve, nivelin e shërbimit ndaj tyre dhe njëkohësisht do të përmirësohet perceptimi që kanë konsumatorët e këtyre shërbimeve në raport me ofruesit e tyre.

Lidhur me shtimin dhe kapacitetin e brendshëm të AKEP-it, dua t'ju falënderoj edhe ju për ndihmën dhe mbështetjen në këtë pikë, ku keni bërë efektive strukturën e re të AKEP-it, të cilën e miratuam në muajin prill dhe njëkohësisht jeni përfshirë në disa bashkëpunime të rëndësishme institucionale me Autoritetin e Konkurrencës dhe me autoritete homologe të vendeve të BE-së, dhe jo vetëm. Jemi në rrugë të sigurt për ta shndërruar sa më shpejt AKEP-in në një institucion ekselence për të realizuar më së miri detyrimet ligjore që ka.

Nuk po zgjatem më shumë në detaje të raportit, pasi edhe ju e thatë, raporti është i plotë, ku kemi paraqitur një material të kondensuar prej afro 90 faqesh. Prandaj jemi të hapur për çdo pyetje dhe çdo çështje, për të cilat mund të kenë interes deputetët e nderuar.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Zoti Baraj, fjala për ju.

Besnik Baraj – Unë kam një pyetje. (Nuk kuptohet) mendoni se ka sjellë konkurrencën e shëndetshme dhe, nëse e ka sjellë këtë konkurrencë, a mendoni që mund të nxitet (nuk kuptohet)?

Eduard Shalsi – Kam edhe unë disa pyetje për të bërë.

Po, zoti Suli.

Rakip Suli – Faleminderit!

..... (Nuk kuptohet) Nga se mund të ketë ardhur kjo rënie? A mund t'u bëni një analizë të faktorëve që kanë sjellë këtë rënie, sepse është një shqetësim për kompanitë që do të investojnë në vitet e mëvonshme?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zonja Gjermani, keni fjalën.

Pastaj e ka fjalën zoti Bitri.

Eglantina Gjermani – Faleminderit për raportin dhe punën e bërë gjatë gjithë vitit të kaluar. Kam dy pyetje që lidhen më shumë me konsumatorët dhe të drejtat e tyre. Nga sa kemi vënë re në përgjithësi, tarifat e telefonive celulare në Shqipëri janë shumë të larta, krahasuar me vende në rajon apo edhe më gjerë.

Pyetja e parë: Çfarë do të bëni ju gjatë vitit që vjen, meqenëse ne do të bëjmë edhe rezolutën në parlament, për t'i përafruar ato tarifa me tarifat e vendeve të tjera?

Pyetja e dytë lidhet me mundësinë e *roaming* zero me vendet e rajonit, sepse është një nismë që është diskutuar, a do të arrihet ajo dhe çfarë do të bëni ju konkretisht vitin që vjen që kjo të realizohet, duke menduar se e ndihmojmë drejtpërdrejt konsumatorin? Përsëri për të drejtat e konsumatorëve, çfarë do të përmirësoni në punën tuaj për ankesat që kanë konsumatorët e telefonive celulare, sidomos për sa i përket mbulimit me rrjet të gjithë vendit dhe të cilësisë së shërbimit?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Bitri.

Robert Bitri – Në vazhdim të këtij problemi, shqetësimi që kam unë, si konsumator, është se në bëjmë abonimin te Vodafone, tek AMC-ja apo tek Albtelekom, problemi është që, kur merr internetin, punon në momentin e parë, më vonë bie cilësia, shfaqen shumë defekte, ndonjëherë ngec, pra një jonormalitet. Kështu që çfarë duhet të bëni ju, edhe me mbështetjen tonë, për t'i kontrolluar më mirë kontratat e tyre, zbatimin e kontratave të tyre, zbatimin e kësaj kontrate ose të

atij niveli që ne të jemi të barabartë me ta. Në qoftë se ne jemi abonentët e tyre, edhe ata kanë detyrimet që të na përgjigjen për të gjitha kontratat që nënshkruajmë me ta. Kështu që në vazhdim të punës suaj, sepse kjo do jetë një nga hallkat tuaj në të ardhmen, i keni të gjitha mundësitë dhe aftësitë..... Në qoftë se keni nevojë, qoftë për ndihmën tonë ligjore, qoftë kërkesa ndaj qeverisë, na thoni dhe ne do t'ju mbështesim që të na mbështesni edhe ne si konsumatorë.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Bitri!

Në fakt, i përmendën pak kolegët dhe i ezauruan një pjesë të pyetjeve të mia. Vjen për t'u përgëzuar marrja e masës së faturimit nga 28 ditë deri në 30 ditë.

Së dyti, ne kemi pasur ankesa në komision në lidhje me bllokimin e numrit. Kemi informacion që kompanitë tashmë arrijnë të bëjnë bllokimin e numrit brenda 24 orëve.

Së treti, një lajm i mirë është që pajtimtarët, të cilët kanë pasur herë pas herë ankesa, do të njoftohen 30 ditë përpara në lidhje me ndryshimet në paketat.

E përmendi pak kolegu imë rënien e të ardhurave. Ju thatë që jeni në procesin e analizave.

Së pari, ne duam të dimë nëse keni një konkluzion deri tani nga se vijnë këto rënie të ardhurash.

Së dyti, ka informacion që cilësia e shërbimeve në zona të ndryshme të Shqipërisë ka rënë, a ka lidhje rënia e të ardhurave dhe sa afekton cilësinë e shërbimit?

E treta, në lidhje me telefoninë fikse duam të dimë si po shkon tregu i telefonisë fikse. Ju jeni Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, çfarë po ndodh më postat?

Ndërkohë që mbetet shqetësim edhe mbikëqyrja e kompanive në drejtim të sigurisë së rrjetit, pra cilat janë masat që ka parashikuar AKEP-i, apo që ka marrë, në lidhje me garantimin e sigurisë së rrjetit?

Faleminderit!

Ilir Zela – Faleminderit për pyetjet dhe për interesin!

Shkurtimisht, do të mundohem t'i adresoj të gjitha.

Në lidhje me daljen e “*PLUS Communication*” nga tregu, sigurisht që nuk është një lajm i mirë kur kemi dalje nga tregu as për investitorët e rinj, por është pjesë e logjikës së ekonomisë së tregut. Do të ketë dalje dhe hyrje në treg, sepse kështu funksionojnë këto tregje. Prirja në vendet e Europës dhe prirja globale është konsolidimi i këtyre tregjeve, gjë që do të thotë se operatorët, të cilët operojnë në shumë vende, mund të përfitojnë nga ekonomitë e shkallës dhe t'i shtrijnë operacionet e tyre edhe në vende të tjera, qoftë më përftim operatorësh të tjerë, qoftë me hyrjen në

aleancë dhe në marrëveshje me to. Në qoftë se vërejmë tregjet e Bashkimit European, mund të vërejmë se një ose dy operatorë tashmë janë thuajse në çdo vend. Ndërsa operatorët më të vegjël e kanë gjetur mënyrën për t'u bërë pjesë e grupeve që këta operatorë kanë, në këtë mënyrë tregjet janë optimizuar, kurse shërbimet përfitojnë nga shkalla. Kjo nuk do të thotë që nuk kanë larmi dhe një pjesë e atyre, që e ofrojnë shërbimin, janë operatorë rrjetesh, një pjesë janë thjesht ofrues shërbimesh, në njëfarë mënyrë, garantohet një ekuilibër ndërmjet numrit të kufizuar të operatorëve të rrjetit dhe numrit të shtuar të ofruesve të shërbimeve, të cilët shërbimet e tyre i bazojnë mbi të perceptuarit e këtyre ofruesve të rrjetit. Kjo është edhe një mënyrë për të kompensuar numrin e ulur të operatorëve të rrjeteve në vende të ndryshme.

Besnik Baraj – Kjo formë rezulton e shëndetshme dhe nuk e ka rrezikun e monopolizimit të tregut?

Ilir Zela – Në analizën tonë rezulton se kjo është prirja në vendet e BE-së, pra reduktimi i numrit të operatorëve kompensohet me shtimin e numrit të shërbimeve. Lidhur me situatën tonë specifike, mund të themi se për shkak të daljes së PLUS-it ka nevojë për më shumë rregullim, pra shtohet vëmendja e AKEP-it në mbikëqyrjen e operacioneve të operatorëve aktualë në treg, rritet shkalla analizave të tregjeve që bëjmë ne dhe vëmendja e AKEP-it për të vendosur masa rregullatore specifike, në mënyrë që ulja e nivelit të konkurrencës, për shkak të daljes së operatorëve nga tregu, të kompensohet nga vëmendja e shtuar lidhur me këto masa.

Në qoftë se daljet nga tregu do të vazhdojnë, pra nga tre operatorë që jemi tani, të shkojmë në dy operatorë dhe rënia e të ardhurave të jetë e tillë, që tregu të mos mundet të mbajë qoftë edhe dy operatorë, sigurisht shkohet me monopolizëm. Por kjo nuk është një situatë e dëshiruar dhe as pjesë e ndonjë agjenti të AKEP apo të ndonjë autoriteti tjetër në Shqipëri. Ajo që ne dëshirojmë është shtimi i konkurrencës, investime efeciente në infrastrukturë, njëkohësisht numër më të madh të ofruesve të shërbimeve, në mënyrë që të kemi konkurrencë në shërbime, në infrastrukturë dhe eficiencë të shtuar, në mënyrë që konsumatorët t'i gëzojnë shërbimet, pa pengesa dhe në përputhje me standardet më të mira të vendeve të BE-së. Në esencë, dalja nga tregu është një veprim që nuk mund të tentohet në veprime administrative, është një veprim racional i pronarëve të atij biznesit dhe në këto kushte ajo çfarë kemi bërë ne si AKEP, është se kemi qenë shumë të vëmendshëm që dalja të ishte sa më pak dramatike për njerëzit, për biznesin dhe për kompanitë që kanë dalë. Për ne është shqetësim i madh edhe në aspektin e AKEP-it si institucion, sepse kjo sjellë edhe rënie e të ardhurave të AKEP-it, por është dalje në funksion të shtimit të eficiencës dhe ne do

ta monitorojmë, që të mos ketë ulje të konkurrencës për shkak të saj. Nuk mund të shtoj asgjë me tepër lidhur me këtë pikë

Lidhur me futjen e operatorëve të rinj në treg, AKEP-i është gjithmonë i vëmendshëm që asnjëherë të mos e ndërpresë mundësinë për hyrje të reja në treg. Një nga mënyrat se si operatorë të rinj hyjnë në këtë fushë, është përmes teknologjive të reja. Për shembull, për spektrin që ne po bëjmë të disponueshëm për operatorët DD1, për spektrin 800 megahers, në kushtet që ne po përgatisim për t'i ofruar këto breza, nuk kemi ndonjë kufizim për hyrës të rinj. Përkundrazi janë të mirëpritur hyrësit e rinj, në qoftë se dëshirojnë të marrin spektrin dhe të ndërtojnë një operatorë në kuadër... Hyrje të reja fiks kemi shumë. Këto muaj kemi pasur shumë hyrje të reja që ofrojnë këtë shërbim dhe nuk mund të themi që ka një situatë jo atraktive në treg për këto shërbime, por gjithmonë atraktiviteti është i lidhur edhe me shkallën e fitimeve në këtë industri me shkallën e të ardhurave, të cilat siç e thashë gjatë vitit që shkoi nuk ishin në nivele. Besoj se do të jetë një vit, ku të ardhurat, por dhe niveli i fitimeve në treg të jetë më të mira, në mënyrë që edhe investimet të rriten.

Në lidhje me shqetësimin që ngrihet për analizën tonë për rënien e të ardhurave dhe nga vjen kjo rënie e të ardhurave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, këtë kemi analizuar dhe kjo lidhet me strukturën e të ardhurave të operatorëve në Shqipëri, e cila ka qenë për një kohë shumë të gjatë e mbështetur në dy kolona.

Së pari, shërbimet me pakicë që ofrohen për pajtimtarët.

Së dyti, të ardhurat që janë gjeneruar nga thirrjet që bëjnë njerëzit drejt Shqipërisë, pra operatorët e huaj, që i paguajnë operatorët tanë.

Çështja është se volumi i këtyre thirrjeve ka ardhur në rënie të vazhdueshme, pavarësisht se tarifat që kanë *charge-u* operatorët tanë kanë qenë në rritje. Pra, rritja e tarifës që kanë bërë operatorët nuk e ka kompensuar dot rënien e volumit. Kjo prirje rënëse e volumit të këtij trafiku vazhdon edhe sot dhe lidhet me disa arsye, kryesisht janë me thirrjet që bëhen përmes viberit, whatsapp dhe faqeve të teknologjike të tjera. Duke qenë se shumica e njerëzve kanë telefonat të zgjuar, i përdorin këto telefonat për të folur nëpërmjet internetit dhe nuk e bëjnë më përmes thirrjeve klasike të telefonit. Kjo është arsyeja kryesore e rënies së këtyre të ardhurave.

Një tjetër arsye pse të adhuroat e operatorëve kanë performancë jo të mirë, është edhe fakti se niveli i tarifave të operatorëve tanë, pra ajo që quhet e ardhur për minutë, tregues i kësaj

industrie, është nën nivelin e vendeve të rajonit, nën nivelin e vendeve të Bashkimit European disa herë dhe kemi dyshime serioze se është edhe nën nivelin e shëndetshëm të një industrie. Pra, këto të ardhura praktikisht vijnë në ulje, sepse kemi dyshime se operatorë të caktuar i kanë ofruar shërbimet e tyre nën kosto dhe i kanë subvencionuar këto shërbime përmes të ardhurave, të cilat i kanë gjeneruar nga burime të tjera, dhe njëri prej tyre, siç e përmenda, është ai i trafikut hyrës ndërkombëtar.

Sigurisht, kjo është vënë në monitorim nga ana jonë, jemi duke vazhduar analizat dhe do të marrim masat e duhura për këtë punë, në mënyrë që të mos kemi situata, ku të rezultojë *morge speak-u* lidhja e marzhit nga operatorë të caktuar. Kjo na çon edhe tek pyetja e zonjës Gjermani, të cilën e falënderoj! Tarifat e operatorëve në Shqipëri, qoftë mobile, qoftë fiksi, janë nën nivelin mesatar të rajonit, janë nën nivelin mesatar të Bashkimit European, janë nën nivelet më të ulëta që mund të ekzistojnë. Në njëfarë mënyre kjo sjell edhe një kufizim të tregut për investime. Siç e përmenda jemi duke parë pjesën kur këto tarifa janë të paarsyeshmërisht të ulëta dhe dëmtojnë sektorin e tregut. Por, nga ana tjetër, jemi duke u siguruar që pajtimtarët, pavarësisht se mesatarisht gëzojnë tarifa shumë të mira, përsëri të mos abuzohen me tarifa abuzive në disa elementë të caktuara të shërbimit, siç janë thirrjet dalëse ndërkombëtare ose tarifat e roaming-ut, kur udhëtojmë jashtë. Për ta analizuar sa më mirë këtë, kemi krijuar Drejtorinë e Mbrojtjes së të Drejtave të Pajtimtarëve, e cila do ta ketë këtë objekt të punës së saj në mënyrë të detajuar.

Lidhur me roaming-un, edhe këtë e kemi diskutuar më përpara në komision, qeveria e Shqipërisë është përfshirë në disa iniciativa rajonale dhe në bashkëpunim me Bashkimin European për t'i ulur tarifat e roaming-ut me vendet e rajonit, por edhe me vendet e Bashkimit European. Shqipëria ka shprehur gatishmërinë e saj pranë Këshillit të Bashkimit Rajonal dhe jemi pjesë e një marrëveshje rajonale për të ulur tarifat e *roaming-ut*. Njëkohësisht, pati iniciativa për marrëveshje dypalëshe të Shqipërisë me vendet e rajonit për t'i ulur dhe zeruar këto tarifa. Një nga prioritetet e samitit të Sofies ishte bashkëpunimi në këto fusha dhe duhet përsëritur fakti se Bashkimi European i ka përfshirë në axhendë parësore edhe uljen e tarifave të *roaming-ut*, të vendeve të rajonit, përfshirë edhe Shqipërinë me vendet e BE-së. Është një proces kompleks, i ka zgjatur Europës rreth 15 vjet për të çuar tarifat e *roaming-ut* në nivelin që kanë tani, por ne shpresojmë se do kemi rezultate të prekshme që nga shtatori i këtij viti, pas samitit të Londrës, që shpresojmë t'i japë një shtytje përpara aspekteve të bashkëpunimit rajonal.

Lidhur me ankesa të gjitha ankesat që janë paraqitur në AKEP gjatë këtij viti janë zgjidhur 100%. Vetëm një ankesë ka shkuar në çështjet gjyqësore. Kemi ngritur një mekanizëm efektiv për shërbimin e ankesave dhe për këtë jemi të kënaqur. Ajo çfarë po përmirësojmë në këtë drejtim është se po instruktojmë operatorët, në mënyrën e duhur, që në çdo pikë shitjeje të ketë informacion të qartë se ku mund të na kontaktojnë njëherë brenda operatorit, por, njëkohësisht, edhe në AKEP. Pra në çdo në dyqan të operatorëve tonë në vende të ndryshme, do të ketë qartësisht të shkruar se ankesat e pajtimtarëve mund të depozitohen. Në këtë mënyrë do të ketë një formular, i cili do të dorëzohet dhe mund të shkojë te operatori, por është në zgjedhjen e pajtimtarit që ky formular të shkojë dhe në AKEP dhe pastaj AKEP-i ka mekanizmin e tij të monitorimit, në mënyrë që ankesa e asnjë pajtimtari të mos ngelte e paadresuar, e pazgjidhur dhe pa përgjigje..

Lidhur me cilësinë, për të cilën e adresuat ju dhe zoti Bitri. Më pëlqeu shumë adresimi juaj për këtë dhe sidomos fjala që tha zoti Bitri që në treg operatorët duhet të jenë të barabartë. Kjo është edhe shqetësim i AKEP-it, një treg konkures ku operatorët të konkurojnë në kushte të barabarta.

(Incizim shumë i dobët)

Një treg ku edhe konsumatori nuk ndihet i vetmuar por duhet të ndihet i fuqishëm dhe nën këtë filozofi do t'i bëjmë një rishikim themelor kushteve të kontratave dhe çfarëdolloj përcaktimi në kontratë, i cili e nëpërkëmb të drejtat e konsumatorit do të hiqet. AKEP-i vlerëson se është plotësisht e mundur që konsumatorët e këtyre shërbimeve të ndihen të trajtuar si njerëz nga operatorët që ofrojnë këtë shërbim, me dinjitet, si shtetas të Republikës së Shqipërisë, të një vendi kandidat për anëtarësimin në BE.

ofrimit të shërbimeve, perceptimi i shërbimeve që ata do të marrin të mos ketë asnjë lloj ndryshimi me mënyrën sesi këto shërbime ofrohen në BE. Për shembull, ligji ynë e ka fare të qartë që për çdo ndryshim në termat e ofrimit të shërbimit, operatori duhet ta njoftojë pajtimtarin 30 ditë përpara. Nuk ndodhte kjo, por kishte një njoftim publik me anë të programit të medias 7 ditë përpara. Jo, kjo nuk ndodh më! Kur bëhet një ndryshim çdo pajtimtar duhet të njoftohet individualisht. Ky është standardi i BE-së. Këtë lloj standardi do ta imponojmë në të gjithë elementët, marrëdhëniet e operatorëve me pajtimtarët e shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

Ju falënderoj për sjelljen në vëmendjen të kësaj çështje të rëndësishme

AKEP do të ndjekë me rigorozitet këtë çështje siç kemi ndjekur edhe çështje të tjera. Sot informuam zotin Shalsi që deri në 65% e kërkesave për portim të pajtimtarëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike në Shqipëri janë refuzuar sistematikisht dhe historikisht. Kjo shifër është një shifër që do të përmbysët në mënyrë imediate, duke filluar nga muaji maj, besoj se mbi 90% e kërkesave do të pranohen dhe nga korriku ky numër do të kalojë mbi 99%. Pra, nga një refuzim 65% do të kalojmë në një pranim 99%. Ky është një element tjetër që do të ndryshojë totalisht perceptimin për këtë problem.

Lidhur me rënien e cilësisë së shërbimit në disa zona të ndryshme të vendit më rezulton se kemi një problem i cili konsiston të mbulimit me shërbim në zona të veçanta të vendit. Perceptohet si rënie nëse disa zona mbeten vetëm shërbimet 2G kurse në zonat e tjera janë edhe 3G-ja edhe 4G-ja, kur kalon nga 4G në 3G perceptohet një rënie e shpejtësisë së internetit, kur kalon nga 3G në 2G edhe një rënie e internetit, ndërkohë që cilësia e telefonatës mbetet konsistente. Ajo çfarë ne po bëjmë tani, kemi nisur një proces verifikimi me operatorët është që ky nivel i mbulimit të respektojë standartet e kërkuara.

Shërbimi duhet të jetë konsistent dhe kushtet e licencat të respektohen, kështu nëse siaps licencës do të mbulojnë me 95% të territorit kjo përqindje duhet të respektohet. Ajo çfarë po përpiqemi është që në disa pika të dedikuara edhe nga një marrëveshje midis operatorëve telefonikë të bëhen investimet që janë për t'u bërë. Për shembull, po pres që Telekomit të ndërtojë kullën që ka marrë përsipër për të ndërtuar dhe aty ku kemi në shërbim Call Center-at dhe në atë zonë është investuar edhe për ndërtimin e rrugës. Po pres që Vodafone të bëjë investime që ka marrë përsipër për të bërë nëzonat përkatëse apo edhe operatorët e tjerë për të ndërtuar kulla të mëdha për përmirësimin e shërbimit telefonik edhe aty ku prezenca e pajtimtarëve është e vogël në numër. Kjo nuk është një nder që operatorët po bëjnë për ne, për përmirësimin e shërbimit, por është detyrë e tyre dhe nga ana e AKEP do të tregohet rigorozitet dhe do të mbikëqyret nga ana jonë që ato gjëra të realizohen në mënyrë konsistente. Kjo do të sjellë edhe respektimin e rritjes së shërbimit, mbulimin në ato zona me pak pajtimtarë.

Kemi një vështirësi, të cilën dua ta ndaj me ju, që është e kuptueshme edhe nga ana jonë edhe nga ana e operatorëve. Paisja me licencë është një gjë jo shumë e lehtë, sepse procesi është kompleks dhe kalon në disa hallka, janë disa problematika dhe nuk është e mundur që operatorët t'i marrin shpejt megjithatë ne po përfshihemi si AKEP për të mbështetur këtë gjë. Mendoj se është një objekt edhe i vëmendjes së komisionit, në mënyrë që kuadri ligjor që ka të bëjë me

dhënien e lejes. Kjo është dhe një nga pengesat kryesore për shtimin e investimeve në infrastrukturën telefonike, por mendojmë se lehtësimi i këtyre barrierave pritet të ndikojë për lehtësimin e operatorëve që investojnë në këtë fushë ku tarifat janë janë inkonsistente.

Lidhur me shërbimet postare mund të them që janë 11 operatorë të cilët ofrojnë shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë. Kemi rritje në të ardhurat totale të sektorit postar, çfarë është një shenjë e mirë.

Janë miratuar nga qeveria procedurat e dizenjimit të ofruesit universal për shërbimet postare. Edhe në lidhje me shërbimet postare them të njëjtat konsiderata që thamë lidhur me shërbimin ndaj pajtimtarëve. Edhe për kontratat qofshin këto të shërbimit universal dhe për shërbimet brenda vendit, por edhe për shërbimet postare ndërkombëtare nga të cilat varen shumë biznese, ne kemi tregues të qartë të cilësisë së shërbimit, si për dhënien e informacionit në kohë për operatorë të ndryshëm postarë, si për kohën e lëvrimit të pakove apo për kohën e lëvrimit të letrave në shërbimet që ofrojnë postat.

Lidhur me sigurinë e rrjeteve, AKEP-i ka në fuqi rregulla të miratuara për sigurinë sipas të cilave operatorët raportojnë lidhur me këto probleme në AKEP në mënyrë sistematike. Jemi duke ndjekur obligimet që ka direktiva e re e BE-së për sigurinë e rrjeteve në mënyrë që edhe ne të kemi nivele të sigurisë të njëjtë me atë që kërkon BE-ja.

Mendoj se i kam adresuar në mënyrë të përmbledhur shqetësimet, por nëse ka diçka tjetër ne jemi të gatshëm t'i elaborojmë ato.

Faleminderit!

Eduard Shalsi- Faleminderit!

Fatkeqësisht ne sot nuk e kemi opozitën.

Do t'i jap falën zotit Baraj.

Besnik Baraj - Komplimente për racionalitetin! Qartazi duket se e njihni problemin shumë mirë, gjë që rezulton edhe nga përgjigjet që dhatë.

Kam vetëm dy komente të vogla që ndoshta mund të përbëjnë një lloj pyetjeje kur kolegja tha lidhur me tarifat që janë, unë mendoj se ka pasur parasysh krahasimin, duke bërë një lloj normalizimi: tarifë me të ardhurat dhe ndoshta nëse shikohet ky lloj raporti, mund të rezultojë që realisht tarifat nuk janë të ulëta, por mund të jenë në nivele të larta.

Së dyti, ju thatë se kanë rënë, dhe është normale, pra kanë rënë të ardhurat për shkak se sot përdoren opsione që ofrohen nga telefonat smart: Viber, WhatsApp e të tjerë.

Unë gjykoj se tendenca e përdorimit të kësaj mundësie do të vijë në rritje. Si rrjedhojë, tendenca për të rënë të ardhurat do të vijë po ashtu në rritje. A mendoni se fakti që u bien të ardhurat do të bëjë që këto kompani të rishikojnë mundësinë e vendosjes së tarifave, qoftë edhe në këto opsionet që sot janë të lira, pa tarifë?

Ilir Zela – Lidhur me çështjen e tarifave, ajo së cilës unë iu referova është e ardhura për minutë-operator, një tregues që ne e përdorim si industri. Janë të ulëta, janë nën mesataren e rajonit, janë nën mesataren e rajonit edhe në terma realë, pra edhe të normalizuara me të ardhurat për frymë në Shqipëri, me GDP-në.

Ato çfarë mund të jenë mbi këtë nivel, janë tarifatat standarde, të listuara nga operatorët. Pra, nëse themi se tarifa për një minutë thirrje është 40 lekë në një operator celular, kjo nuk është ajo e ardhura për minutë, që thotë, por kjo është tarifa e listës. Në fakt, njerëzit përdorin një tarifë tjetër, që është tarifa e paketës, ku mesatarizohet gjithë përdorimi i tregut, dhe del një shifër, që është diku te 6 euro, pra te 3 lekë për minutë. Pra, nuk është 40 lekë shifra reale e cila tregon përdorimin real të minutave.

Lidhur me të ardhurat, siç e tha zoti deputet kjo tendencë mund edhe të vazhdojë. Nuk është diçka që mund të mos vazhdojë. Është një tendencë me të cilën ballafaqohen edhe tregje të tjera, nuk është vetëm tregu ynë. Pse? Sepse shërbimet po kalojnë nga shërbime klasike të telefonisë, në shërbime interneti, dhe modelet e operatorëve për të gjeneruar të ardhura, deri tani janë të bazuara te telefonia. Tani nuk kemi më kompani telefonike, sepse kompanitë telefonike po shndërrohen në kompani IT. Kjo është një prirje globale.

Tani ku e shohin operatorët potencialin për të gjeneruar më shumë të ardhura? E shohin pikërisht te shtimi i shërbimeve që ata ofrojnë në lidhje me shërbimet e komunikimit, ose i shikojnë te aplikacionet. Një pjesë e tyre janë në paketë. Operatorët po nxisin përdorimin e tyre, përveç shërbimit bazë që japin, siç është lidhja me internet ose me shërbimin telefonik. Ata mund të gjenerojnë të ardhura edhe nga aplikacionet shtesë, të cilat...

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Na vjen keq që sot nuk i kemi përfaqësuesit e opozitës. Në mos gaboj, që prej rreth një muaji nuk marrin pjesë në komision. I kanë hyrë një rrugë pa krye. Ajo që doja të thosha është se, pavarësisht se ata nuk janë këtu, ne do t'i informojmë se, disa shqetësime që i kemi dëgjuar bashkërisht, në lidhje me faturat 28-ditore, për shembull, apo me faktin e vështirësive të

komunikimit apo me shqetësimin qytetar të mungesave paraprake të njoftimeve nga operatorët. Jua bëj me dije, duke dashur të ndiejnë se hallet dhe problemet e shqiptarëve zgjidhen duke vënë gishtin në plagë, duke kërkuar llogari tek institucionet, në mënyrë që të kemi këto rezultate që kemi. Efektet janë të dukshme dhe të prekshme dhe për këtë gjë do të donim t'ju përgëzonim, do të donim t'ju inkurajonim të vazhdonit me të njëjtin ritëm.

Mirë atëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, patjetër. Gjermani ka diçka për të shtuar.

Eglantina Gjermani – Më tepër në formën e sugjerimit.

Meqenëse po flasim sërish për konsumatorët, vitin që vjen jemi para një angazhimi më të madh nga ju, që telefonitë celulare të jenë shumë më të kujdesshme dhe të jenë (...) për konsumatorët me të ardhura të ulëta, duke i dhënë një alternativë shërbimi apo mundësi për të pasur akses në këto shërbime.

Lidhur me shqetësimin që ju përmendët për marrjen e lejeve infrastrukturore, meqenëse jam marrë me atë fushë, e kam merak ta theksoj se lejet e ndërtimit jepen online. Kompanitë kanë stafet përkatëse për ta bërë këtë aplikim. Sipas ligjit të planifikimit të territorit, ka edhe afate të përcaktuara ligjore, që duhet të marrin. Në qoftë se nuk marrin bëhet me miratim në heshtje.

Në qoftë se kompanitë i bëjnë vërtetë dokumentet në rregull, është e pamundur të mos u jepet leja e ndërtimit. Por, në këtë rast, shqetësimi im është i lidhur me këto antenat, që kompanitë celulare vendosin, nëse kanë apo jo ndikim negativ në mjedis e në jetën e qytetarëve. Mbase ju mund ta monitoroni këtë gjë, dhe të jeni të kujdesshëm si për ndërgjegjësimin e qytetarëve, por pa dyshim edhe të kompanive, që këto kulla që ngrenë të mos kenë ndikim negativ në mjedis.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Gjermani! Ndonjë koment të fundit, keni?

Ilir Zela – Ta them unë fjalën e fundit. Po ju lutem për tridhjetë sekonda kohë. Çështjet që adresoi zonja janë me të vërtetë thelbësore. Nuk më takon të hyj në debat në lidhje me çështjen e lejeve. Ajo që unë paraqita këtu është shqetësimi që marr nga operatorët, të cilët nuk arrijnë të marrin lejet. Me sa di unë, leja e fundit që ka arritur të marrë një operator, është e vitit 2016.

Do të isha shumë i lumtur nëse përpjekjeve tona për më shumë efektivitet në këtë gjë, t'u bashkoheni dhe ju, e besoj se kjo do të jetë e mirëpritur edhe nga operatorët.

Eduard Shalsi – Disa raste konkrete aplikimesh, që keni, mund t'i ndjekim dhe ne.

Ilir Zela – Faleminderit!

E dyta, lidhur me rrezatimet, është një pikë shumë e rëndësishme, që duhet ta ndaj me ju e me publikun: fakti se kjo çështje është në vëmendjen maksimale të AKEP-it. Jo se AKEP-i është organ i ngarkuar nga ligji për kontrollin e rrezatimeve në Shqipëri, sepse është Ministria e Shëndetësisë dhe autoriteti përkatës, që kontrollon rrezatimet, e të cilët bëjnë një punë të shkëlqyer në këtë drejtim, e me ta do të bashkëpunojmë me ta edhe ne. Jemi në fazën e nënshkrimit të një memorandum bashkëpunimi me ta. Kjo çështje është në vëmendjen tonë, sepse ne ndjejmë përgjegjësi për këtë çështje, pasi jemi autorizuesit e përdorimit të brezave të frekuencave në Shqipëri.

Unë ju garantoj juve dhe publikun, se në të gjitha lejet që japim për antena, ne vendosim kufizime në lidhje me fuqinë e rrezatimit të këtyre frekuencave, të cilat janë nën nivelet e rekomanduara e të aprovuara nga organizatat përkatëse ndërkombëtare lidhur me fuqinë e rrezatimit. Ne kontrollojmë që kushtet e përdorimit të këtyre autorizimeve nga operatorët të respektohen rigorozisht. Kemi pajisje monitoruese matëse, të cilat masin fuqinë e rrezatuar. Për çdo ankesë që kemi pasur në lidhje me “rrezikun” e këtyre rrezatimeve, të këtyre antenave të celularëve, ne kemi bërë matje, dhe në çdo rast që kemi bërë matje, deri më tani, fuqia e rrezatuar nga antenat e operatorëve celularë në Shqipëri është nën standardet e lejuara, të cilat garantojnë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve edhe në zonat më të dendura, ku antenat janë më afër. Për çdo largim me disa metra nga antena, fuqia e rrezatuar bie në mënyrë eksponenciale, dhe nuk ka asnjë lloj mundësie që fuqia e rrezatuar të mbërrijë tek njerëzit përmbi limitet e lejuara.

Ju falënderoj dhe një herë.

Eduard Shalsi – Atëherë, ne do të draftojmë një rekomandim, që do të jetë për vitin 2017 e për vitin 2018. Do ta ndajmë bashkë me kolegët, e sigurisht edhe me AKEP-in. pastaj do ta shqyrtojmë, për ta miratuar dhe pasur parasysh për vitin 2018.

Shihemi në mbledhjen e ardhshme. Faleminderit edhe një herë!

MBYLLET MBLEDHJA